



BULETINI INFORMATIV

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

KORRIK 2024



Tryezë e Rrumbullakët me institucionet përgjegjëse që administrojnë ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

U zhvillua në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë një tryezë e Rrumbullakët me institucionet përgjegjëse që administrojnë ndihmën juridike të garantuar nga shteti (*Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, përfaqësues nga Gjykatat dhe Organizatat Jofitimprurëse, etj*), në drejtim të evidentimit të problematikave dhe përmirësimit të skemës së shërbimit ligjor falas.



Prezantimi i Raportit "Aksesi në Drejtësi" realizuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim UNDP.

U organizua një tryezë e rrumbullakët për të diskutuar gjetjet dhe sfidat kryesore lidhur me Qasjen në Drejtësi dhe Reformimin e Sistemit të ndihmës juridike. Studim i kryer si pjesë e projektit "Zgjerimi i shërbimeve të ndihmës juridike për gratë dhe burrat në Shqipëri", financuar nga ADA dhe realizuar nga UNDP, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas.



Mbledhja e IV e Komitetit Drejtues të Programit "Akses i barabartë gjinor në mundësitë ekonomike".

Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas z.Ergys Qirici prezantoi aktivitetet kryesore që lidhen me Fushatën e Informimit për të Drejtat e Grave në Mbledhjen e IV të Komitetit Drejtues të Programit "Akses i barabartë gjinor në mundësitë ekonomike", organizuar nga Expertise France/AFD.

Aktivitetet e kryera nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore



QSHNJP Kurbin, në datën 04.07.2024 realizoi një aktivitet në kuadër të fushatës ndërgjegjësuese/informuese me Kryetarin e Shoqatës së Para dhe Tetraplegjikëve Z. N.Ndoca, Z.R.Rrahmani, Kryetar i Shoqatës së Verbërve Kurbin. Takimi u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Qendrës "Fara e Mirësisë" dhe tema e takimit ishin barazia dhe mosdiskriminimi i këtij komuniteti.

QSHNJP Dibër, në datën 15.07.2024 realizoi një aktivitet në ambientet e shoqatës për personat me aftësi të kufizuar dhe personave që nuk shikojnë Dibër me praninë e kryetarit të shoqatës Z.I.Kamberi, sekretarit Z.K.Pupli, si dhe disa anëtarëve të kësaj shoqate.

QSHNJP Fier, në datën 03.07.2024 organizoi në bashkëpunim me përfaqësuesen e Komisionerit Për Mbrojtjen Nga Diskriminimi, një takim pranë ambienteve të zyrës me disa prej mësuesëve në Qarkun e Fierit të cilat janë edhe kategori e veçantë "persona me aftësi të kufizuar".



QSHNJP Elbasan, në datën 17.07.2024 zhvilloi një aktivitet në Qendrën Artizanale Tradita Ime me disa gra kategori përfituese të ligjit nr.111/2017.

QSHNJP Elbasan, në datën 29.07.2024 në kuadër të 30 Korrikut "Dita Botërore Kundër Trafikimit të Personave" zhvilloi një "sesion informimi street low" me qytetarët në kuadër të ndërgjegjësimit dhe informimit mbi Ligjin 111/2017 "Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti"



QSHNJP Kavajë, në datën 14.07.2024 organizoi një aktivitet në bashkëpunim me Shoqatën "ANAD", ku të pranishëm ishin krahas përfaqësues të Shoqatës edhe persona me aftësi të kufizuar (persona që nuk dëgjojnë dhe flasin).

QSHNJP Kavajë dhe Durrës zhvilluan një takim informues në datën 24.07.2024 me kategorinë e veçantë "Të miturit në konflikt me ligjin", në bashkëpunim me I.E.V.P Kavajë.



QSHNJP Durrës, në datën 05.07.2024, në kuadër të informimit dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve, organizoi një aktivitet "Street Law" mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti me temë "Promovimi i Ndhmës Juridike Falas" pranë Bashkisë Shijak.

QSHNJP Durrës, në kuadër të promovimit së ndihmës juridike Falas, zhvilloi një takim me përgjegjësën e Shoqatës së tetraplegjikëve z.Adivije dhe u diskutua për referimin e rasteve të zyra jonë për personat përfitues si kategori e veçantë.

QSHNJP Durrës, në datën 18.07.2024 në kuadër të informimit dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve, organizoi një aktivitet "Street Law" mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti me temë "Promovimi i Ndhmës Juridike Falas" në qytetin e Durrësit.

QSHNJP Përmet, në datën 23.07.2024 në kuadër të informimit dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve, organizoi një takim në qendrën e pensionistëve.

QSHNJP Pogradec, në datën 25.07.2024 organizoi një sesion informimi "Street Low" në shëtitoren e qytetit dhe ambientin e dedikuar moshës së tretë për t'u organizuar në kohën e lirë.



QSHNJP Berat, në vijim të takimeve bashkëpunuese institucionale mori pjesë në datën 12.07.2024 në takimin e zhvilluar nga Drejtoria e Shërbimit Social, ku u diskutua mbi bashkëpunimin që kanë drejtoritë të cilat merren me trajtimin e shtresave në nevojë me grupet e terrenit.

QSHNJP Berat, në datën 19.07.2024 në kuadër të informimit dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve, ka organizuar një aktivitet "Street Law" mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti me temë "Promovimi i Ndhmës Juridike Falas" në qytetin e Beratit.


QSHNJP Berat, në datën 30.07.2024, në kuadër të Ditës Botërore kundër Trafikimit të Personave mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga Rrjeti i organizatave URAT në bashkëpunim me Bashkinë Berat "Stop the Traffik", "UN Gift", me mbështetjen financiare të ARISE Foundation dhe Talitha Kum.





QSHNJP Tropojë dhe Kukës, në datën 18.07.2024, zhvilluan një takim me Kancelarin Z.Sh.Mulosmani dhe stafin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, mbi problematikat e përfitimit të ndihmës juridike dytësore.




QSHNJP Tropojë, në datën 18.07.2024, zhvilloi një takim me Kryetarin e Dhomës së Avokatisë Kukës Z.I.Nerguti, me temë diskutimi kërkesat për ndihmë juridike dytësore dhe caktimi i avokatëve për ndihmë juridike dytësore.


 **QSHNJP Tiranë**, në datën 05.07.2024, organizoi një takim ndërgjegjësues në bashkëpunim me Shërbimin Ligjor Falas, Tiranë, ku u diskutua mbi Ligjin nr 111/2027 dhe kategoritë e vecanta.


 **QSHNJP Tiranë**, në datën 08.07.2024, organizoi një aktivitet street law në qytetin e Tiranës, sesion informues për qytetarët mbi ndihmën juridike falas të garantuar nga shteti.

 **QSHNJP Tiranë**, në datën 15.07.2024, organizoi një takim në kuadër të bashkëpunimit me përfaqësues të Bashkisë Vorë, Drejtoresha dhe Koordinatori vendor i dhunës në familje.





 **QSHNJP Tiranë**, në datën 16.07.2024, organizoi një takim informues me qytetarë që i përkisnin kategorisë së vecantë (i verbër), mbi prezantimin e Manualit "Si të përfitojmë ndihmë juridike falas" në gjuhën Braille.

 **QSHNJP Tiranë**, në datën 25.07.2024, organizoi një takim në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit Social Shtetëror me përfaqësuese Zj.M.Ismailati, në Njësinë Administrative nr.9 me gra,vajza, me qëllim rritjen e aksesit të grave dhe vajzave ndaj ndihmës juridike falas në kuadër të fushatave të ndryshme me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional.


 **QSHNJP Gjirokastrë**, në datën 25.07.2024, organizoi një aktivitet me temë "Dita Botërore Kundër Trafikimit të Personave", pranë Qendrës së Trajtitit të Rasteve të Dhunës në Familje.




 **QSHNJP Lushnjë**, në datën 30.07.2024, në kuadër të ditës botërore kundër trafikimit të personave, zhvilloi një aktivitet në ambientet e zyrës me gra dhe vajza të kategorisë së veçantë të Ligjit.


 **QSHNJP Kukës dhe Tropojë**, në datën 18.07.2024, në kuadër të bashkëpunimit zhvilluan një takim "Street Law" me qytetarët në zonat kryesore të qytetit për informimin dhe adresimin e tyre pranë qendrave Tropojë dhe Kukës për të përfituar ndihmë ligjore falas.




 **QSHNJP Pukë**, në datën 30.07.2024, në kuadër të Ditës botërore kundër trafikimit të Personave, organizoi një takim ndërgjegjësues dhe informues "Street Law" në qendër të qytetit Pukë.


 **QSHNJP Vlorë**, në datën 08.07.2024, mori pjesë në takimin e organizuar në Bashkinë Vlorë, me Ekspertin e Pavarur të OKB për çështjet e diskriminimit me bazë identitetin gjinor dhe orientimin seksual, z.G.Reid, me z.B.Griffey, Human Rights Officer, OHCHR dhe me Kryetarin e Bashkisë Vlorë, z.E.Dredha.



 **QSHNJP Vlorë**, në datën 09.07.2024 zhvilloi një aktivitet "Street Law", në kuadër të informimit, ndërgjegjësimit dhe promovimit të drejtpërdrejtë të tyre për shërbimet tona.

 **QSHNJP Vlorë**, në datën 11.07.2024, mori pjesë në takimin e organizuar mbi platformën e angazhimit konstruktiv të punëve në komunitet, organizuar nga disa institucione shtetërore dhe OJF.



 **QSHNJP Shkodër**, në datën 30.07.2024, në kuadër të Dites Nderkombëtare të Viktimave të Trafikimit, organizoi një takim pranë Qendrës së trajtimit të rasteve të viktimave të trafikimit (e cila ndodhet në ambientet e Spitalit Rajonal Shkodër).